

autorë: Aldo Merkoçi / Xheni Lame

QEVERISJA E HAPUR E PARLAMENTIT NË RAJON DHE NË SHIPËRI



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian, gjetjet dhe rekomandimet janë të autor-it/ve dhe nuk përbëjnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve

autorë: Aldo Merkoçi / Xheni Lame

QEVERISJA E HAPUR E PARLAMENTIT NË RAJON DHE NË SHIPËRI

KY PROJEKT ËSHTË MBËSHTETUR FINANCIARISHT NGA BASHKIMI EUROPIAN. OPINIONET, GJETJET DHE REKOMANDIMET JANË TË AUTOR-IT/VE DHE NUK PËRBËJNË DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E DONATORËVE.

TIRANË, MAJ 2017

HYRJE

Në bashkëpunim me partnerët nga rrjeti rajonal i NGO-ve “Action SEE”, Lëvizja MJAF! përgatiti dokumentin përmes të cilit analizohet niveli i transparencës, hapjes dhe llogaridhënies së Pushtetit Legjislativ në Rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Dokumenti prezanton rezultatet e kërkimit bazuar në metodologji shkencore, zhvilluar nga anëtarët e Action SEE, përgjatë muajve të kaluar. Qëllimi i aktiviteteve tona është të përcaktojmë kushtet reale ku ndodhet rajoni dhe të bëjmë rekomandime për përmirësimin e tyre përmes një matjeje objektive të hapjes parlamentare në rajon. Gjithashtu, synimi është të përmirësohet respektimi i parimeve të qeverisjes së mirë, në të cilën hapja zë një hapësirë të rëndësishme.

Të gjithë Parlamentet rajonale duhet të sigurojnë një hapje të plotë të punës së tyre dhe, në këtë mënyrë, të demostrojnë përgjegjësi politike dhe respektim të parimeve themelore të demokracisë. Përmes sigurimit të të gjithë informacioneve përkatëse, parlamentet duhet të mos pengojnë pashqyrimin e punës së tyre. Vetëm institucionet e hapura dhe të përgjegjshme mund të punojnë në ndërtimin e një shoqërie demokratike, ku të gjithë vendet e rajonit po bëjnë përpjekje.

Deklarata mbi Hapjen Parlamentare përcakton detyrimet e parlamenteve në sugjerimin e mënyrës më të mirë, me të cilën, parlamenti duhet t’u sigurojë qytetarëve ndihmë juridike gjatë ushtrimit të të drejtës së tyre për akses në informacionet parlamentare. Theksohet një detyrim për parlamentet për të inkurajuar hapjen dhe të ndajnë shembuj të praktikave të mira me parlamentet e tjerë, me qëllim që të rrisin hapjen dhe transparencën. Më tej, të afirmohet bashkëpunimi me organizatat jo-qeveritare (OJQ), të cilat punojnë me monitorimin e punës së parlamentit dhe qytetarët me qëllim që të sigurohet se informacionet e parlamentit janë të plota, të sakta dhe të përshtatshme.

Duke marrë në konsideratë të gjitha pikat e përmendura, është e nevojshme që të gjithë parlamentet rajonale, të cilët ende nuk e kanë nënshkruar Deklaratën e Hapjes Parlamentare, ta nënshkruajnë atë dhe, gjithashtu, të punojnë në implementimin e saj.

Dokumenti ynë u drejtohet vendimmarrësve në parlamentet e vendeve të rajonit. Gjithashtu mund të jetë i vlefshëm për përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare dhe kolegët e OJQ-ve të cilët punojnë me këto çështje.

Ne jemi në dispozicionin tuaj për sugjerime, kritika dashamirëse dhe diskutime në lidhje me dokumentin.

HAPJA E PUSHTETIT LEGJISLATIV NË RAJON

Parlamentet Rajonale vlerësohen mesatarisht me arritjen e 63% të kriterëve të hapjes. Ky rezultat nuk është i kënaqshëm, duke marrë në konsideratë se po flasim për institucione, të cilët janë zgjedhur drejtpërdrejt dhe janë përgjegjëse për qytetarët.

Parlamentet kanë një rol kyç në sistemet demokratike ndaj ato duhet të jenë bartës të një procesi i cili, u mundëson qytetarëve një monitorim më efektiv të punës së institucioneve. Megjithëse, sikurse ishte rasti me pushtetin ekzekutiv, organet më të larta legjislative në rajon, nuk kanë një qasje strategjike ndaj politikës së hapjes. Kërkesa për hapje mund të jetë jo e drejtpërdrejtë nga Kushtetuta, Regulloret e Proçedurës dhe akte të tjera dhe si të tilla ato janë subjekt i interpretimeve dhe humorit të maxhorancës parlamentare.

Informacioni në lidhje me punën e parlamentit i përket publikut¹ dhe, për rrjedhojë, është e nevojshme të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme niveli i ekzistencës së një kulture të hapjes parlamentare. Politikat e hapjes duhet të zhvillohen duke ndjekur trendet e informacionit dhe të komunikimit, duke përdorur teknologjitë e reja dhe në publikimin e të dhënave në formate të lexueshme e përpunueshme. Kjo mbështetet nga të dhënat e dëshmuara nga parlamentet në rajon, të dhënat e të cilëve nuk janë të dedikuara të publikohen në format të hapur (Open Data) dhe ndërkohë vlera e përdorimit të tyre bëhet minimale prej formatit jo të përshtatshëm.

Transparencë e pamjaftueshme mbi informacionin organizativ dhe financiar

Kjo përcaktohet prej monitorimeve, ku parlamentet janë përgjithësisht jo transparente kur bëhet fjalë për publikimin e të dhënave nga sesionet e komisioneve parlamentare. Shumica e parlamenteve nuk publikojnë të dhënat e votimeve dhe listën e deputetëve të cilët marrin pjesë në mbledhje dhe seanca. Përveç kësaj, në shumicën e vendeve mbledhjet e komisioneve nuk transmetohen.

Shumica e parlamenteve në rajon, duhet të afirmojnë parimin e finacave publike dhe hapjes. Parlamentet përgjithësisht nuk arrijnë as minimumin e standardeve ndërkombëtare për transparencën buxhetare², e cila imponon disponueshmërinë e dokumenteve financiare për publikun. Në faqet zyrtare të internetit të shumicës së parlamenteve, qytetarët nuk mundën të gjejnë buxhetet për tri vitet e shkuara. Përveç kësaj, një shumicë dërmuese nuk publikon bilancet përfundimtare. Parlamentet duhet të ndërmarrin kontrole për shpenzimet publike përgjatë vitit dhe të publikojnë raportet e ndërmjetme mbi shpenzimet e buxhetit.

1) Shqipëria gjithashtu e ka nënshkruar këtë deklaratë, <https://openingparliament.org/declaration/>, <https://openingparliament.org/static/pdfs/english.pdf>, e aksesuar 19.04.2017

2) Best Practices for Budget Transparency, OECD, 2002. Available at: <https://goo.gl/qamVDW>; Guidelines for Parliamentary Websites, Inter-Parliamentary Union, 2009. Available at: <https://goo.gl/gD2Wg0>. Access: 27.03.2017.

Komunikim i pamjaftueshëm me qytetarët dhe mundësia e tyre për pjesëmarrje

Parlamentet e rajonit duhet të forcojnë funksionin e tyre përfaqësues përmes ndërtimit të komunikimit me qytetarët dhe përfshirjen e tyre në procesin e krijimit të politikave. Parlamentet duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë zhvillimit të shërbimeve elektronike.

Parlamentet duhet të jenë në dispozicion të qytetarëve dhe të ngrenë mundësi për të vendosur komunikim përmes telefonit ose e-mailit, është e nevojshme të krijohen kanale inovative mbi një komunikim të dyanshëm me qytetarët. Gjithashtu, është e nevojshme që në mënyrë më aktive të përdoren mekanizmat ekzistues të komunikimit, veçanërisht rrjetet sociale. Monitorimi përcaktoi se shumica e parlamenteve nuk kanë llogaritë e tyre në rrjetet sociale ose ata nuk e përdorin atë në mënyrë aktive.

Përveç kësaj, monitorimi njohu nevojën për forcimin e kapaciteteve për një zbatim të plotë dhe të vazhdueshëm të Ligjit për të Drejtën e Informimit³.

Sjellja (JO) etike e deputetëve

Një zbatim i vazhdueshëm i Kodeve të Sjelljes është me rëndësi thelbësore për rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë politike dhe besimit të qytetarëve mbi punën parlamentare. Megjithatë, ndonëse disa vende të rajonit nuk kanë miratuar Kodin e Sjelljes, vendet e tjera as nuk e promovojnë atë në mënyrë aktive, as nuk e zbatojnë efektivisht. Parlamentet e rajonit duhet të ndërtojnë mekanizma të qarta për monitorimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes nga deputetët dhe sanksione për çdo shkelje të standarteve të përcaktuara etike. Praktikrat rajonale tregojnë se shkeljet e Kodeve të Sjelljes në shumicën e rasteve nuk rezultojnë në sanksionimin e sjelljeve të papërshtatshme dhe zakonisht bëhen subjekt i marrëveshjeve politike. Gjithashtu, është e nevojshme të vendosen rregulla, të cilat detyrojnë anëtarët e parlamenteve të publikojnë dokumentet e procedurave në lidhje me shkeljen e dispozitave të Kodit. Në këtë mënyrë do të rritet transparenca edhe për këto procedura.

Efekti i kontrollit parlamentar mbi pushtetet e tjera

Monitorimi përcaktoi se janë ngritur një numër mekanizmesh për kontrollin parlamentar të pushtetit ekzekutiv në vendet e rajonit.

3) Nga monitorimi është vënë re se shumica e parlamenteve në rajon nuk kanë një sistem të qëndrueshëm trajnimi apo udhëzues për shërbimin civil dhe në këtë mënyrë, punonjësit civil do të aksesojnë të dhëna që janë publikuar sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe të supozojnë detyrime të tjera të parashikuara nga ligji. Në rastin e Shqipërisë, ligji në fuqi për të drejtën e informimit është Ligji Nr.119/2014, date 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Megjithatë, implementimi i tyre është zakonisht i natyrës formale. Në praktikë efektet e dukshme të kontrollit mungojnë dhe janë shumë të rralla rastet të cilat kanë dhënë rezultate specifike lidhur me përcaktimin e përgjegjshmërisë dhe sanksionet për përfaqësuesit e ekzekutivit apo degët e tjera të pushtetit.

Parlamentet nuk duhet të jenë vende për miratimet pa kritikë të propozimeve të pushtetit ekzekutiv, por vende për rishikimin dhe kontrollin e këtij efektiv. Detyrimet legjislative të anëtarëve të parlamentit nuk duhet të jetë arsye për neglizhimin e funksionit të kontrollit, i cili paraqet një nga garancitë më domethënëse të demokracisë.

Të gjithë parlamentet e rajonit janë të detyruar të ndërmarrin nisma për implementim të plotë të mekanizmave ekzistues dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë politike.

HAPJA E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bazuar në rezultatet e kërkimit Kuvendi i Shqipërisë mbërrin në 60% të plotësimin të treguesve të hapjes. Ky rezultat nënkupton se ka ende punë për t'u bërë për të pasur një performancë më të mirë të aktivitetit të Kuvendit të Shqipërisë. Është shumë e rëndësishme për t'u përmendur se janë disa praktika të mira të zbatuara nga administrata e Kuvendit, por ende është i nevojshëm miratimi i praktikave ndërkombëtare për ta bërë Kuvendin e Shqipërisë më të hapur.

Në faqen e internetit të Kuvendit⁴ mund të gjenden informacione mbi listën e deputetëve dhe përmbledhjet e jetëshkrimit të tyre. Çdo tri javë, planifikohet për diskutim kalendari i draft-ligjeve në komisionet parlamentare dhe përditësohet në faqen zyrtare. Janë publikuar të gjitha aktet ligjore si projektligjet, ligjet e miratuara dhe amendamentet e paraqitura. Gjithashtu, faqja e internetit përmban të dhëna për pjesëmarrjen e deputetëve në seancat e komisionit dhe të gjitha diskutimet e bëra lidhur me axhendën e këtyre komisioneve.

Edhe pse Kuvendi ka arritur rezultatet më të mira ndër institucionet shqiptare, ka disa çështje të rëndësishme të cilat, ky institucion duhet të trajtojë me qëllim të arritjes së standardeve ndërkombëtare të hapjes dhe të përgjegjshmërisë. Në vijim po japim rekomandime kyçe për vazhdimësinë e zhvillimeve në këtë drejtim:

TË PLANIFIKOJË NË MËNYRË STRATEGJIKE ZHVILLIMET PËR HAPJEN DHE LLOGARIDHËNIEN E KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËRMES IDENTIFIKIMIT TË PROBLEMEVE KRYESORE DHE MËNYRAVE PËR ZGJIDHJEN E TYRE. ËSHTË E RËNDËSISHME TË PËRMIRËSOHEN RREGULLAT E PROCEDURËS DHE KODI I SJELLJES PËR DEPUTETËT.

4) <https://www.parlament.al/>, e aksesuar më 19.04.2017

Është e nevojshme për të qenë më të rreptë në specifikimet e Rregullores së Procedurës në aspektin e efektivitetit dhe cilësisë së zbatimit në sesionet parlamentare. Kuvendi i Shqipërisë publikon në faqen e tij zyrtare rendin e ditës për sesionet vijuese, por diskutimet e mbajtura gjatë seancave plenare rrallë janë në përputhje me agjendën e planifikuar. Për shembull, në pjesën e parë të sesionit planifikon diskutime lidhur me projektligjet që do të miratohen dhe pjesa e dytë përbëhet nga diskutime për çështje të tjera. Por deputetët, që marrin pjesë në seancë, diskutojnë për çështje të tjera jashtë rendit të ditës, të tilla si performanca e ekzekutivit apo çështje të tjera të interesit publik, duke devijuar draft-ligjet e planifikuara për diskutim. Gjithashtu, Kuvendi duhet të zbatojë Ligjin Nr.146/2014, datë 30.10.2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", duke siguruar informacion për konkluzionet dhe rekomandimet e miratuara në dëgjuesat publike. Ende nuk ka informacion se si rekomandimet e grupeve të interesit reflektohen në projektligjet përfundimtare të diskutuara në Kuvendin e Shqipërisë, të cilat kërkojnë përmirësimin e mekanizmave të zbatimit të këtij ligji.

Kodi i Sjelljes, gjithashtu, përfaqëson një mekanizëm që ka nevojë të përmirësohet në Kuvendin e Shqipërisë. Ka pasur disa raste që janë marrë masa disiplinore ndaj deputetëve, por këto masa merren vetëm në raste serioze të thyerjes së rregulloreve. Kodi i Sjelljes duhet të rishikohet me qëllim që të parandalojë ose të ndëshkojë deputetët apo zyrtarët publikë, jo vetëm në lidhje me dhunën fizike, por edhe fyerjet gjatë seancave.

Duke pasur në konsideratë të gjitha pikat e sipërpërmendura, është e qartë se Kuvendi i Shqipërisë duhet të merret në mënyrë aktive me to dhe me çështje të tjera. Është e nevojshme të ngrihet një grup pune, i cili do të bëjë analizën e problemeve dhe një plan ndryshimesh në dokumentacion dhe praktikën, të cilat nuk funksionojnë në mënyrë të duhur.

Kuvendi i Shqipërisë transmeton drejtpërdrejt seancat plenare në televizionin kombëtar, duke e bërë këtë institucion më transparent për qytetarët mbi ligjet e diskutuara. Gjithashtu, rezultatet e votimeve të ligjeve publikohen në faqen e internetit.

Drejt një sistemi krejtësisht transparent të vendimmarrjes në Kuvend është e nevojshme të rritet transparenca e punës së organeve vartëse në punën e tij. Përveç kësaj, është e nevojshme që rregullisht të publikohen informacione lidhur me pjesëmarrjen e deputetëve në seancat plenare⁵ dhe në këtë mënyrë qytetarët do të kenë mundësi të drejtpërdrejtë njohjeje me përgjegjshmërinë e punës së personave që ata kanë votuar në zgjedhje.

5) Në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, përmes monitorimit të mbledhjeve të komisioneve parlamentare, projekt i Lëvizjes MJAF! (Unë Votoj), janë evidentuar raste, ku në procesverbalet e publikuara të mbledhjeve, kanë rezultuar emra deputetësh të cilët nuk kanë qenë pjesë në to (presenzë fiktive). Kjo për arsye sepse deputetët prezentë realisht nuk plotësojnë kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve.

Me rëndësi për t'u përmendur është edhe mungesa e ligjit që rregullon lobistët dhe aktivitetet e tyre në Shqipëri. Lobistët janë përgjegjës për të ndërmarrë fushata publike të organizuara, në mënyrë që të ushtrorjnë presion mbi qeverinë për ekzekutimin e aksioneve të politikave publike. Pikërisht për këtë rol që ata kanë mbi procesin legjislativ lind nevoja e hartimit të një ligji rregullues.

PËRMIRËSIMI I KOMUNIKIMIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË KUNDREJT QYTETARËVE PËRMES HAPJES SË NJË KANALI PËR KOMUNIKIM "TË SHPEJTË" NË DY RRJETE SOCIALE. T'U MUNDËSOJË QYTETARËVE TË DORËZOJNË PETICIONE ELEKTRONIKE.

Kuvendi i Shqipërisë ka praktika të mira online të komunikimit me qytetarët dhe OJQ-të, por është e nevojshme për praktika të tjera për t'u mundësuar qytetarëve të dërgojnë peticione online. Kuvendi i Shqipërisë duhet të hapë një kanal të drejtpërdrejtë komunikimi me qytetarët nëpërmjet rrjeteve sociale. Aktualisht, nuk ka një veprimtari aktive në këtë drejtim dhe kështu qytetarët mbeten të privuar nga marrja e informacionit.

Qytetarët duhet të kenë një kanal të shpejtë, nëpërmjet të cilit ata mund të dërgojnë iniciativa tek deputetët, të cilët, janë të detyruar ti marrin në konsideratë ato dhe t'i vendosin ato në procedurën parlamentare. Kjo nënkupton dërgimin i peticioneve dhe iniciativave në mënyrë elektronike për të ushtruar të drejtën e tyre politike në një mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më të aksesueshme, Parlamenti nuk u ofron mundësi të tilla qytetarëve. Bashkë me përcaktimin e mundësisë për peticionet elektronike, është e nevojshme të miratohet plani i komunikimit për promovimin e këtyre lloj peticionesh, kështu një numër më i madh qytetarësh do të kenë mundësi të informohen për këtë.

MIRATIMIN E NJË METODOLOGJIE UNIKE PËR VLERËSIMIN E ZGJIDHJEVE LIGJORE (ANALIZA E NDKIMIT RREGULLATOR⁶) DHE FORCIMI I NDJESHËM I KAPACITETEVE TË PARLAMENTIT PËR KRIJIMIN E KËTYRE STUDIMEVE.

Aktiviteti legjislativ i Kuvendit duhet të përmirësohet në atë mënyrë që të vlerësojë ndikimin e punës së zgjidhjeve ligjore gjatë legjislaturës së tij (analiza e RIA). Ligjet e propozuara nga Kuvendi duhet të kalojnë një procedurë, e cila të tregojë ndikimin e ndryshimeve në jetën e qytetarëve. Në këtë proces duhet të përfshihen të gjitha partitë përmes konsultimeve, derisa rezultatet e analizës të transmetohen në mënyrë transparente tek qytetarët. Rezultatet e analizës duhet të vlerësohen nga ekspertët për të rritur cilësinë. Për momentin ndodhemi në situatën ku shumica e ligjeve që diskutohen dhe miratohen në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nuk kalojnë në procedura ndikimi dhe studimet e fizibilitetit janë vetëm të shkruara në letër, por jo të realizuar faktikisht.

PËRMIRËSIM TË TRANSPARENCËS BUXHETORE TË KUVENDIT DHE PËRQASJEN E TIJ PËR QYTETARËT. TË RRITET TRANSPARENCA E PROCESIT TË MIRATIMIT TË BUXHETIT TË SHQIPËRISË. TË RRITET TRANSPARENCA E PROKURIMEVE PUBLIKE.

Është e nevojshme të zgjerohet publikimi i buxhetit dhe llogaritë përmbledhëse në faqen e internetit. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka publikuar ligjet fillestare mbi buxhetin vjetor dhe versionin përfundimtar për tri vitet e fundit, por vend për përmirësim ka ende. Qytetarët e kanë të pamundur të gjejnë të publikuar llogari të buxhetit, që janë të dedikuara për ta. Kuvendi duhet t'i paraqesë qytetarëve planet buxhetore në një mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme përgjatë miratimit të buxhetit. Gjithashtu, në dokumentacionin e publikuar nga Kuvendi është vënë re mungesa e rishikimeve apo aprovimeve të aktiviteteve buxhetore apo financuese publike. Për sa i takon prokurimeve publike, vendi ynë ka ende shumë punë për të bërë lidhur me transparencën e tyre. Për Shqipërinë, Kuvendi ka rezultuar me 43% të treguesve të transparencës të plotësuar lidhur me prokurimet publike, ku ndër të tjera, qytetarët e kanë të pamundur të aksesojnë rezultatet përfundimtare të ofertave të mëdha të prokurimeve.

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Hapja përfaqëson një kusht kyç të demokracisë, pasi ajo u lejon qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendim-marrje efektive dhe pasjen e institucioneve të përgjegjshme për politikën, të cilat ato ndjekin.

Rreth botës, institucionet ndërmarrin aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e transparencës së tyre dhe llogaridhënien te qytetarët. Indeksi Rajonal për Hapjen e Parlamentit është ndërtuar në qëllim të përcaktimit se në cilën shkallë qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin dhe kuptojnë informacionin e institucioneve të tyre.

Indeksi Rajonal i Hapjes mat shkallën në të cilën Parlamentet e Ballkanit Perëndimor janë të hapur për qytetarët dhe shoqërinë, bazuar në katër parimet bazë si vijon: 1) **Transparenca**, 2) **Aksesueshmëria**, 3) **Integriteti**, dhe 4) **Efektshmëria**.

Parimi i **transparencës** përfshin informacionin organizativ, buxhetin dhe procedurat e prokurimeve publike, të cilat janë në dispozicion të publikut dhe të publikuara. **Aksesueshmëria** është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për akses të lirë në informacion, duke përmirësuar disponueshmërinë e informacionit përmes mekanizmeve të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. **Integriteti** përbëhet nga mekanizmi i parandalimit të korrupsionit, mbajtjen e kodit etik dhe rregulloret e lobimit. Parimi i fundit, **Efektshmëria** i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të zbatuara nga Institucionet.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet sikurse dhe shembuj të praktikave të mira, këto parime janë zhvilluar më tej përmes treguesve specifik cilësorë dhe sasiorë, të cilët janë vlerësuar në bazat e: disponueshmërisë së informacionit në websitet zyrtare, shqyrtimin e kuadrit ligjor për çështje të veçanta, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione.

PËRMES RRETH 100 TREGUESVE, NE KEMI MATUR DHE ANALIZUAR HAPJEN E PARLAMENTEVE NË RAJON DHE JANË MBLEDHUR 1000 TË DHËNA. MATJET JANË KRYER NË PERIUdhËN NGA TETORI DERI NË FUND TË DHJETORIT 2016.



